



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD U MITROVICU – BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.186/2012

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, (e vendosur ne objektin e Degës së kësaj Gjykate në Vushtrri), si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual Faton Ademi, në çështjen juridike të paditësit: _____ nga Mitrovica të cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Av. _____ kundër të paditurës: Kompania e Sigurimeve _____ të cilën e përfaqëson: _____ sipas autorizimit me shkrim baza e kontestit: kompensim të dëmit, pas mbajtjes së seancës kryesore të datës: 26.03.2014 me prezencën e palëve ndërgjyqëse, me datën: 18.04.2014 bie këtë:

A K T G J Y K I M

- **APROVOHET** pjesërisht kërkesëpadia e paditëses si e BAZUAR dhe
- **OBLIGOHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “ _____ që në emër të kompensimit të dëmit për të gjitha llojet e dëmit t’ia kompensojë paditëses shumën prej **4,936.50** euro dhe atë siç vijon:

1. Në emër të dhimbjeve të pësuar fizike shumën prej **1.500 euro**
2. Në emër të frikës për të gjitha kategoritë e frikës shumën prej **1.000 euro**
3. Në emër të zvogëlimit të aftësisë së përgjithshme jetësore shumën prej **1.000 euro**
4. Në emër të shëmtimit shumën prej **1 000 euro**
5. Në emër të kujdesit të huaj shumën prej **150 euro**
6. Në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej **50 euro**
7. Në emër të rehabilitim klimatik shumën prej **200 euro**
8. Në emër të shpenzimeve për shërim shumën prej **36.50 euro**

Totali=4.936.50 euro.

Të gjitha këto brenda afatit 15 ditor me kamatë sikurse për mjetet e deponuara në bankë për periudhë një vjeqare pa destinim të caktuar nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm:

- **OBLIGOHET** e paditura që në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguajë paditësit shumën prej 766.80 euro, dhe atë për përpilim të padisë shumën prej 93.60 euro, për 4 (katër) përfaqësime (një seancë të shtyer) shumën prej 473.20 euro ($3.5 \times 135.20 = 473.20$ euro), për 2 ekspertiza shumën 200 euro ($2 \times 100 = 200$ euro) si dhe në emër të taksës për padi shumën prej 20 euro, si dhe gjykatës në emër të taksës për vendim shumën prej 20 euro euro në afat 15 ditor nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.
- Pjesa tjetër e Kërkesëpadisë refuzohet si e PA BAZUAR

A r s y e t i m

Paditesi përmes padisë së datës: 31.08.2012, ka kërkuar nga gjykata që ta obligon palën e paditur që në emër të kompensimit të dëmit për lëndimet e pësuar në aksident trafiku, e paditura të zhdëmtohet.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditëses bëri precizimin e kërkesëpadisë, ku kërkoj shumën prej 10.340.90 euro për të gjitha llojet e kompensimit të dëmit me kamatë ligjore prej ushtrimit të padisë gjer në pagesën definitive.

E paditura nuk e ka kundërshtuar bazën e kërkesëpadisë, pasi në këtë lëndë është shfrytëzuar ekspertiza e komunikacionit e përpiluar në lëndën penale, pasi alët ndërgjyqëse nuk e kundërshtuan një gjë të tillë.

E paditura përmes përfaqësuesit të saj i ofruan paditësit ofertën për marrëveshje gjyqësore në shumën prej 3 000 euro për të gjitha llojet e kompenzimit të dëmit.

Në seancën kryesore gjykata administroi këto prova: mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit Ing. [] i përpiluar në lëndën penale, udhëzimi i dt.04.02.2013 lëshuar nga QKMF-së në Mitrovicë, raporti i lëshuar nga internisti [] mjek pranë Spitalit Regjional "Dr. []", përshkrimi i terapisë i bërë nga mjeku [] dt.25.02.2013, kuponi fiskal i dt.25.02.2013, përshkrimi i barnave i dt.07.08.2013, urdhëresa për dhënien e terapisë parenterale i përshkruar nga mjekja [], kuponi fiskal i dt.26.03.2013, raporti i fiziatrit i dt.27.03.2013, udhëzimi i dt.26.03.2013, raporti i QKUK-së raporti i emergjencës i dt.03.01.2012, kërkesa drejtuar QKU-së repartit të Radiologjisë e dt.21.06.2012, kopja e letërnjoftimit të paditësit, kuponi fiskal i dt.25.02.2013, raporti internistit [] i dt.04.02.2013, udhëzimi i specialistit mjekësisë familjare dt.04.02.2013, raporti i dt.04.02.2013 lëshuar nga poliklinika [], raporti i policisë mbi aksidentit i dt.02.01.2012, raporti spec. të ORL-së dt.04.01.2012, raporti i spec. të ORL-së 24.01.2012, raporti i Dr të jekësisë [] i dt.24.01.2012, raporti

i dt.03.01.2012, procesverbali mbi gjësendet të cilat i janë gjetur tek paditësi ditën e aksidentit, raporti i Dr. dt.24.01.2012, raporti i dt.14.01.2012, raporti i dt.31.01.2012, dëftespagesa e dt.31.01.2012, dëftesëpagesa e dt.14.02.2012, dëftesëpagesa dt.24.01.2012.

Gjykata provat e administruara i vlerësoi në pajtim me nenin 7 dhe 8 të LPK-së dhe erdhi në këto perfundime:

Nuk është kontestuese fakti se paditësi ka qenë pjesmarrës në aksidentin e komunikacionit në cilësinë e bashkudhëtarit të automjetit A , i cili ka qenë i siguar tek e paditura, këtë fakt gjykata e vërteton në bazë të raportit të Policisë.

Nuk është kontestues fakti se shkaktar i aksidentit ka qenë ngasësi i veturës apo automjetit A, që ka qenë i siguar tek e paditura.

Gjykata në këtë qështje juridiko-civile e shfrytëzoi ekspertizën e bërë në lëndën penale, pasi një gjë të tillë nuk e kundërshtuan palët ndërgjyqëse dhe me qëllim të ekonomizimit të procedurës.

Se paditësi nga aksidenti në fjalë ka pësuar lëndime trupore kjo vërtetohet si në bazë të dokumentacionit mjekësorë poashtu edhe në bazë të ekspertizave të ekspertëve mjekësorë dhënë në seancë kryesore.

Sa i përket lartësisë së dëmit dhe kompenzimit të të njëjtit gjykata mori për bazë ekspertizat mjekësore të cilat në mënyrë të plotë dhe objektive përcaktuan shkallën e lëndimit të paditësit si dhe natyrën e lëndimeve, të cilave ekspertiza gjykata ua fali besimin e plotë.

Sipas ekspertit të ortopedisë si pasojë e këtij aksidenti paditëses i është zvogëluar aftësia e përgjithshme jetësore në shkallë prej 5 %, ndërsa lëndimi karakterizohet si lëndim i rëndë trupor, ndërsa i njëjti ka pësuar dhimbje fizike të intensitetit të rëndë deri në 30 minuta deri në fillimin e ofrimit të ndihmës mjekësore, dhimbje fizike të intensiteti të rëndë 48 orë, të mesëm 21 ditë dhe të ultë për 6 muaj. I njëjti sipas ekspertit ka si rezultat i aksidentit ka pësuar shëmtim trupor që karakterizohet si shëmtim në shkallë të lehtë, në regjionin e hundës në gjatësi rreth 4 cm, në regjionin e mbivetullës së majtë dhe cikatrikseve në regjionin e majtë të fytyrës.

Sipas ekspertës së psikiatrisë paditësi ka pësuar frikë primaredisa sekonda, frikë sekondare e intensitetit të lartë që nënkupton frikën prej momentit të lëndimit deri në dërgimin në QKU Prishtinë, frikë rreth dhënies së ndihmës së parë, e cila frikë ka zgjatur rreth 2 orë, frikë sekondare e intensitetit mesatar e manifestuar me rregullime të gjumit, disponimi dhe rikujtime të herëpashershme të ngjarjes e përcjellur edhe me shmangie rreth bisedës dhe vendit të aksidentit si dhe frikë rreth pasojave eventuale kjo frikë ka zgjatur për dy muaj, frika sekondare e intensitetit të ultë e manifestuar me simptome të lartë përmendura ka zgjatur për një muaj.

Gjykata ia fali besimin e plotë ekspertizave të ekspertëve pasi të njëjta ishin profesionale dhe objektive.

Gjykata me rastin e përcaktimit në lidhje me lartësinë e kompenzimit edhe pse nuk e obligon u bazua edhe në kriteret e përcaktuara nga ana e disa kompanive, kriteret këto të caktuara në vitin 2001.

Gjykata nuk e bazoi aktgjykimin e saj në lidhje me lartësinë tërësisht në këto kriteret sepse të njëjtat nuk kanë karakter obligues, dhe se të njëjtat fare nuk janë modifikuar për gjatë këtyre viteve, të njëjtat janë të ulta në krahasim me lëndimet dhe natyrën e tyre, si dhe të njëjtat nuk janë ndryshuar pavarësisht faktit se edhe legjislacioni që mbulon fushën e sigurimeve dhe mbulon sferën e sigurimeve është ndryshuar.

Sa i përket të drejtës materiale gjykata u bazua në nenet: 155, 178, 158, neni 200 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i vjetri i aplikuar në rastin konkret meqenëse marrëdhënia e detyrimit është krijuar në kohën kur ky ligj ka qenë në fuqi.

Sa i përket kamatës gjykata u bazua në nenin 277 të Ligjit për Marrëdhëniet Juridike, i vjetri pasi është kërkuar kamata nga koha e parashtrimit të padisë, ndërsa padia është parashtruar në kohën kur në fuqi ka qenë Ligji i vjetër i Marrëdhënieve të Detyrimeve, sid he në atë kohë ka qenë në fuqi edhe baza juridike.

Sa i përket pjesës tjetër të kërkesëpadisë përveq asaj të aprovuar, gjykata e refuzoi si të PA BAZUAR, sepse e njëjta nuk pati mundësi të provohej në lartësin e saj qoftë në aspektin e praktikës së deritanishme gjyqësore në rastet e tilla kur kemi këtë shkallë të zvogëlimit të aftësisë së përgjithshme jetësore.

Gjykata, lidhur me vendosjen mbi shpenzimet procedurale, u bazua në nenin 452, par.3 dhe 5 të LPK-së, ngase, konsideroi se paditësit duhet ti njihet e drejta në shpenzime procedurale, duke marrë parasysh faktin se edhe pse paditësit kërkesëpadia i është aprovuar pjesërisht, ekspertizat e marra kanë qenë të domosdoshme, ndërsa për shpenzime gjyqësore, u bazua në nenin 10.12, në lidhje me nenin 10.1 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së për Unifikim të Taksave Gjyqësore nr. 2008/2.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.Nr.186/2012 datë: 18.04.2014

GJYQTARI
Faton Ademi

Faton Ademi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtën e ankesës në afat prej 15 ditor nga dita e pranimit së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë – nëpërmjet kësaj gjykate.